

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kryeministri**

**U R D H Ë R**

Nr. 78, datë 8.5.2006

**PËR**

**KRIJIMIN E GRUPEVE MINISTRORE TË PUNËS PËR**  
**STRATEGJI, BUXHET DHE INTEGRIM, “GSBI”**


Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, miratuar me vendimin nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave,

**U R D H Ë R O J:**

1. Krijimin, në çdo ministri, të Grupit (ministror të punës) për Strategji, Buxhet dhe Integrim “GSBI”, për menaxhimin dhe sigurimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), të miratuar nga Komiteti Ndërministror për Planifikimin Strategjik.
2. Përbërja dhe rregullat e funksionimit të Grupit për Strategji, Buxhet dhe Integrim “GSBI”, përcaktohen me urdhër të ministrit përkatës, në përputhje me termat e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
3. Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim, “GSBI”, të krijohet, në çdo ministri, brenda datës 15 maj 2006.
4. Ngarkohen ministrat për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

  
**SALI BERISHA**